

## Katër Tropet Kryesore

*Metafora, metonimia, dhe sinekdoka* i referohen diçkaje sikur ajo të ishte diçka tjetër (Sister). Kurse tropja e katërt, *ironia*, kundërshton atë që shprehet prej gjuhës. Me metaforën mund të përfshihet edhe simileja e alegoria. Sinekdoka, metalepsa, dhe antonomasia mund të shihen si tipe të metonomisë. Për disa, personifikimi është një tip i sinekdokës. Përfundimisht, ironia ndahet në disa nënklasa.

Sipas Burke, ndërsa të katër tropet kryesore—*metafora, metonimia, sinekdoka, dhe ironia*—janë të dallueshme prej njëna-tjetrës, ky dallim nuk është gjithmonë i qartë.

**Metonomia** lidhë dy terma që kanë lidhje të ngushtë me njëna-tjetrën, ndërsa **metafora** lidhë dy fjalë të cilave u mungon kjo lidhje. Metonimia dallohet edhe prej **sinekdokës** sepse sinekdoka lidhë dy pjesë të një gjaje, p.sh., tansinë me pjesën, jo dy terma. Dallimi në mes metonomisë e **metalepsis** është se metalepsa ka lidhje më të largët me fjalën të cilës ajo i referohet. **Ironia** dallohet prej tri figurave të tjera sepse ajo ndërtohet në konceptin e kundërshtisë.

Duke i shikua të katër koncepte jo aq shumë si mjete figurative se sa në rolin e tyre me zbulua dhe përshkrua të vërtetën, Burke shkruan:

Në vend të *metaforës* mund të thona *përspektivë*.

Në vend të *metonomisë* mund të thona *thjeshtim*.

Në vend të *sinekdokës* mund të thona *përfaqsim*.

Në vend të *ironisë* mund të thona *dialektikë*, të cilën ai a përkufizon si ‘*ka qëllim me na dhanë një përfaqsim nëpërmjet përdorimit të përspektivave të ndërlidhuna ose ndërvepruese*’.

### 1. Metafora

μεταφέρω metaphérō ‘transferoj’ < μετά metá, ‘pastaj, tjetra’ + φέρω phérō ‘me bartë’.

*Metafora ka ngjasi me similenë dhe alegorinë*. Por, ndërsa metafora është mjeti kryesor i autorit që favorizon gjuhën poetike, simileja është një mjet tipik i gjuhës bisedimore, dhe alegoria është një mjet letrar ku një tregim i tanë mund të simbolizojë diçka tjetër.

Metafora formohet kur dy gjana që u përkasin klasash të ndryshme identifikohen me njëna-tjetrën. Në efekt, një gjaje i referohet sikur ajo të ishte një gjë tjetër; ose diçka shihet prej përspektivës së një diçkaje tjetër (Burke).

Metafora jep një krahasim të ngjashëm me njësimin në arithmetikë, p.sh., *Kjo ishte dita e fundit e komedisë së saj. (Ajo vdiq.)*

*jeta = komedi (Jeta është komedi)*

Metafora përdoret edhe me emëna diçka ose një ngjarje, p.sh.,

*doreza e derës*

*flitët e librit*

*len dielli.*

*perëndoi hana.*

*syni i gjiplanës.*

*shtrati i lumit*

Në traditën gojore (MM, Murimi i Gjelinës):

*Besë për besë trimat i'n lidhun*

*Me besë lidhnuju, o djelm e mí,*

*Dy të mbajt beset ka'n dalë*

Në këta rreshta mësohet që terminologjia e ritit të besës është metaforike:

dhanja e besës: *me lidhë besën*

thymja e besës: *me dalë beset*

Alegoria përdoret me fshehtë diçka për të cilën nuk mund të flitet. Ky përdorim është paradoksal sepse hulumtimet etimologjike tregojnë që alegoria përdoret me shpallë diçka në një mbledhje: ἄλλος ἄλλος, 'tjetër' + ἀγορά ἄγορά 'mbledhje. Në shqip, kjo do të ishte sikur me shpallë diçka në Log ose në kuvend.

### *Metafora e zgjanuome*

Ky tip metafore mund të vazhdojë në rreshta e paragrafe të tana, ku metaforat pasuese lidhen me metaforën kryesore.

*Jeta është një lundrim <sup>(metafora kryesore)</sup> që na çon nëpër ujëna të panjohuna, disa të ambëla, disa të krypuna, disa të qeta, disa të stuhishëme.*

*ujëna të panjohuna – ngjarje të paprituna >*

*ngjarje të kandëshme > ngjarje të hidhuna >*

*jetë të qetë > jetë të mbushun me emocione*

### *Metafora e vdekun*

Metafora quhet e vdekun kur ajo humbë origjinalitetin dhe freskinë; nuk e çuditë dëgjuesin a lexuesin, p.sh,

*Ishte fjalambël.*

*Kishte ramë kambë e krye në dashni.*

*Mblidhe veten.*

*Mos i bjer kujt në qafë.*

*Muret kanë veshë.*

*Na hodhi hi syve.  
Qeshë natyra.  
S'ta kam zanë diellin.  
U vrã qielli.  
Vetura ishte akull e ré.*

### Simileja<sup>1</sup>

I njëjti parim si në përdorimin e metaforës, përveçse këtu dy gjanat që krahasohen ndërpriten prej një fjale krahasuese, p.sh., *si, me ngjã*, etj. Ky krahasim është i ngjashëm me konceptin arithmetik të afërsisë.

$1 \sim 1$  (000x)

a) *Jeta (është si / ~) komedi.*

b) *Flokkuqja ishte e pabesë. Ajo i ngjante një dhelpëne të uritun.*

Në b), 'ngjante' mund të zëvendësohet me 'si'; *Ajo ishte si dhelpën...*

### Alegoria

ἀλληγορία allegoría: gjuhë e maskuome ose figurative; ἄλλος allos 'tjetër, e ndryshëm' + ἀγορεύω agoreuo 'me folë në kuvend'

Alegoria është një metaforë e pandërpreme, e cila mund të shtrihet në të gjith veprën. Ajo është një përfaqsim vizual ose narrativist ku personazhet, vendet, dhe ngjarjet mund të kenë kuptim simbolik; përfaqsojnë ose simbolizojnë diçka tjetër, tipikisht, të ngarkuome me kuptim moral, politik, shoqnor, etj.

Shpesh, në alegori dobisohet personifikimi, një mjet letrar ku kafshëve e gjanave u jepen cilsi njerzore.

Në gjuhën shqipe, një alegori e njohun është poema e Ndre Mjedjes 'Vaji i Bylbylit'<sup>2</sup>.

*Po shkribet bora  
Dimni po shkon;  
Bylbyl i vorfën  
Pse po gjëmon?*

Në këtë strofë, shkrimja e borës përfaqson dobsimin e parandorisë otomane, kurse dimëni përfaqson gjendjen e shqiptarëve të pushtuom.

*Bylbyl i vorfën,  
Çou, mos rri shkeret.*

<sup>1</sup> Duke u bazua në parimin se fjala 'trope / kthesë' nënkupton një ndryshim në kuptimin e një fjale, disa argumentojnë se 'simileja' nuk është një trope e vërtetë, por funksioni i saj krahasues / referues është shumë i ngjashëm me metaforën.

<sup>2</sup> bylbyl (lat. sylvia luscinia) – emën zogu (fjalë persjane e sjellun në shqip nëpërmjet otomanishtes).

Duke e pa që i gjith Ballkani po ngrihej kundër perandorisë, Mjedja shqetsohet për ata (shqiptarët) që nuk po i bashkoheshin kësaj lufte nacional-çlirimtare; po mbetnin shkret, po shkretoheshin, po mbetnin vetëm. Prandaj, ai i nxitë shqiptarët që të përgatiteshin me fillua luftën nacional-çlirimtare.

Në poezinë ‘Liria’, Mjedja pohon që, megjithëse pjesa më e madhe e Shqipnisë nuk zhvilloi një luftë nacional-çlirimtare si vendet tjera të ballkanit, në malet e Shqipnisë (Në fakt, kryesisht në Malsia e Madhe) kishte nisun përgatitja për një luftë kundër errsinës shekullore:

*“Lirim, lirim!” -- bërtet gjithkrah malsia.  
A ka lirim ky dhë që na shkel kamba,  
a veç t’mjerin e mblon anemban’ robnia?  
Flutro shqipe, flutro kah çelet lama,  
sielliu maleve përreth që ka Shqipnia,  
e vështroje ku i del liritit ama.*

*Por nuk u shuejt edhe, jo, shqiptaria:  
Lodhun prej bekrash që mizori e njeti,  
lodhun prej terri ku robnimi e qiti,  
shpreson me e zgjue fluturim mënia.*

*E kyre: Ndër male po përhapet shkëndija  
e liritit t’Atdheut; fshehtas shëtiti  
kasoll’ për kasoll’ rreth buneve e soditi  
frymë të re tue zbrazun për gjithkrah, bija*

*e Skanderbegut. Që ndër djepa rritin  
nanat e Hotit djelmënin’ ushtore  
e idhnim n’anmikun nëpër gj’iu qitin.  
E nalt, ndër maja, bukuri mbretnore.*

Në këtë poezi, kandvështrimi i jepet shqyponjës, e cila simbolizon esencën e Shqiptarisë; jo se fjala ‘shqiptar’ ka lidhje me fjalën ‘shqyponjë’, por sepse në këto kushe Shqiptarët duhej të kërkonin liri të plotë.

Tipikisht, alegoria u referohet koncepteve morale, politike, a fetare të një shoqnie njerzore. Prandaj, personazhet e veprës duhet të jenë vetëm simbolike. Kështu kuajt në poemën e Gjekë Marinajt simbolizojnë popullsinë e vendeve ku sundon trania; komunizmi.

## 2. Metonimia

Fjala μετωνυμία metōnumiá ‘ndërrim emëni’ vjen prej greqishtes.

Përdorimi i metonomisë përkufizohet si *zëvendësim i një fjale a fraze me një fjalë e frazë me të cilën ajo ka lidhje të afërt*. Termi ‘zëvendësim’ mund të kuptohet edhe si ‘referencë’. Për shembull, fjala ‘kunorë’ i referohet fjalës ‘mbret’ me të cilën ajo ka lidhje të afërt; mbreti e mban kunorën mbë krye. Por, fjala ‘kunorë’ mund t’i referohet edhe një *monarkie*, p.sh., *Kunora britanike zgjodhi trashëgimtarin e ri*.

Metonomia duhet dallua prej disa figurave të përafërta me të.

Metonomia: *Dj koncepte kanë lidhje të afërt; njëni përdoret për tjetrin*.

Sinekdoka: *Pjesa qëndron për tansinë ose tansia për pjesën*.

Metalepsa: *Një koncept i njohun përdoret në rrethana të reja*.

Polisemia: *Kuptimi varet prej rrethanave ose kontekstit*. Për shembull *termi ‘shtypi’ është një fjalë me përdorim metonimik që mund t’u referohet edhe gazetarëve ose edhe gazetave*.

Burke thotë që metonomia kumton diçka abstrakte në terma të diçkaje konkrete, p. sh., emocionet (abstrakte) me anë të zemrës (konkrete):

zemra = emocione

Dhimbja është një gjendje fizike a psikologjike, por ajo nuk mund të shqisohet (është abstrakte). Në anën tjetër, zemra është një objekt i shqisueshëm. Metonimikisht, ky organ ka evoluom si simbolizues i ndjenjave.

Burke e pendson metoniminë me zvoglimin (en. reduction). Ai shton që ndërsa *metonimia* është një mjet i ‘realizmit poetik’, reduktimi është një mjet i ‘realizmit shkencor’. *Realiteti poetik* arrihet nëpërmjet ndërveprimit të personazheve, ndërsa *realiteti shkencor* arrihet nëpërmjet përshkrimit faktik, p.sh.,

*Kur i ra vazjoja në tokë, fëmija shikoi të amën dhe u skuq.*

Në kë fjalë, drama, ‘realiteti poetik’ zhvillohet nëpërmjet *ndërveprimit* të personazheve (nanes dhe fëmijës), ndërsa ‘realiteti shkencor’ evidentohet prej *shqisimit* (skuqjes së fëtyrës së fëmijës).

Në këtë situatë, nuk mjafton me emëna gjendjen (en. state) sepse termi ‘u turpnua’ është term abstrakt. Me konkretizua këtë abstraksion, ne e reduktojmë atë në diçka që mund të shqisohet, ‘skuqjen’ e faqeve të fëmijës. Kështu gjendja shpirtnore (turpnimi) thjeshtohet në një fenomen fizik (skuqjen).

Analogjikisht, skuqja e faqeve simbolizon gjendjen e trupit (realitetin shkencor) ashtu si turpnimi simbolizon sjelljen (realitetin poetik). Ajo që shumica e lexuesve të sotëm kërkojnë është konkretizmi, jo abstraksionet. Prandaj, ‘u skuq’, jo u turpnua.

Termat duhet të kenë lidhje të afërt me njëna-tjetrën, p.sh., skuqja me turpnimin, Shtëpia e Bardhë me Presidentin, kunora me monarkinë a mbretin, etj. Është afërsia e kësaj lidhjeje që lejon zëvendësimin e njënit term për tjetrin; *turpnimi* quhet *skuqje*.

|          |                               |          |
|----------|-------------------------------|----------|
| skuqja   | Presidenti                    | Mbreti   |
| turpnimi | Shtëpia e Bardhë<br>(Qeveria) | Monarkia |

Metonimia realizohet kur:

- subjekti zëvendësohet ose përfaqësohet prej adjunktit (*cilsisë*)
- adjunkti (*cilsia ose karakteristika*) qëndron për subjektin
- shkak për efektin (*pasojën*)
- efekti për shkakun
- konkretja për abstrakten, etj.

### Shkaku zëvendëson ose përfaqëson efektin

Pena shkakton fjalët. Fjalët e shkruome kanë fuqí.

shkaku = *pena*, e cila përdoret me shkrua

efekti = *shkrimi*, fuqia e shkrimit

Përdorimi i metonomisë: *Pena është më e fortë se shpata.*

Në të vërtetë autori dëshiron me thanë: *Fuqia e shkrimit (efekti) është më e fortë se shpata.* Por ai e zëvendëson '*fuqinë e shkrimit*' me atë që shkakton shkrimin (penën).

Edhe 'shpata' përdoret metonimikisht (shkak për efekt).

shkaku = *shpata*, e cila përdoret me dhunua

efekti = *dhuna*, frika e dhunës

Vërej krahasimin pasues:

1) Asertë metonimike: *Pena është më e fortë se shpata.*

2) Asertë direkte: *Shkrimi është më i fortë se dhuna.*

Megjithse kjo thanje është bëmë një klishe, lexuesi i sotëm do të perferonte 1) sepse pena e shpata janë konkrete, kurse shkrimi e dhuna janë abstrakte.

### Pasoja zëvendëson shkakun.

*Lekët e patën rruajtun lirinë e tyre duke derdhë gjak* (pasoja/efekti).

Efektet, a pasojat, e derdhjes së gjakut janë të shumta, p.sh., njeriu mund të theret a të pritët. Por, këtu flitet për një pasojë specifike të derdhjes së gjakut, plagosjes a vramjes në luftë; *lufta shkakton derdhjen e gjakut.*

Asertë metonimike: *Lekët e ruajtën lirinë e tynë duke derdhë gjak.*

Asertë direkte: *Lekët e ruajtën lirinë e tynë duke luftua.*

Shembull tjetër: *Stalinistët e vendosën sundin e tynë me gjak. Prejse gjaku ishte në themel të sistemit të tynë, ata vranë edhe njëni-tjetrin.*

Këtu fjala ‘gjak’ është pasoja e mënyrës me të cilën stalinistët morën sundin në Europën Lindore.

shkaku: *vrasja*

pasoja: *gjaku*

Gjaku (pasoja) përdoret në vend të shkakut (vrasjes); goditjes me plumb.

### **Disa metonimí të tjera:**

Autori për veprën: *Po studjonte Mirash Ivanajin (veprën e tij).*

Institucioni për zyrtarin: *Gjykata (gjykatësi) nuk do ta fali këtë veprim.*

Kontrolluesi për të kontrolluomin. *Një gur (qëlluesi) theu panelin e dritares*

Objekti për detyrën: *Këto janë pronat e Kunorës (mbretit, monarkisë).*

Objekti për personin: *Shkollat (nxanësit) kanë pushim sot.*

Vendi për institucionin: *Shtëpia e bardhë (qeveria) ngriti tarifat.*

Vendi për ngjarjen. *Deçiçi (ngritja e flamurit) tregoi që disa shqiptarë nuk ishin të kënaqun me shkëputje territoriale; ata donin edhe shkëputje shpirtnore e kulturore; pavarësi prej otomanizmit, jo vetëm otoamanëve.*

### **Metalepsa**

grc. μεταλήψις *metalepsis* ‘metalepsa’.

Kjo figurë dobisohet kur një fjalë, ose një figurë letrare, përdoret në rrethana të reja kumtore, kur diçka ka lidhje të zbehtë me diçka tjetër, ose kur një term përdoret si një shkak i zbehtë për një pasojë. Këto aspekte e bajnë këtë figurë shumë të përshtatëshme për komedianët, por ajo mund të përdoret në çfarëdo shkrimi, përfshi edhe tragjedinë.

Zbehja mund të ndodhi për arsye të ndryshme. Por, në qoftë se formojmë një lidhje, sado të dobët, në mes vdekjes e zbehjes, atherë zbehja përdoret *metalepsisht*, p.sh., *Vdekja (zbehtsia) i mbuloi fëtyrën; vdiq.*

Shprehja e Christopher Marlowit mund të modifikohet në kontekstin shqiptar duke zëvendësua Norën për Helenen.

*A ishte kjo fëtyra që lëshoi Kelmendin kundër bordave lindore.*

Në këto rrethana kumtore, fjala 'fëtyrë' është përdorun metalepsisht, në rrethana të reja dhe me kuptim të ri. Kuptimi i kësaj shprehjeje është që Nora kishte bukuri mahnitëse. Nuk ka gjasë që pasha ta kishte pamë atë. Por ai ia kishte dëgjuom zanin. Në këtë kontekst, termi 'fëtyrë' nënkupton 'arsye'.

Përdorimi i konceptit 'fëtyrë' mund të zëvendësohet me një fjalë tjetër dhe të përdoret në rrethana krejt të ndryshme, p.sh.,

*A ishte kjo vdekja<sup>3</sup> që shkaktoi Luftën e Madhe?*

Këtu, 'vdekja' është përdorun në rrethana të reja: *vdekja = arsyeja*.

Metalepsa përdoret më së miri kur ajo ndërtohet prej figurash tjera, veçsisht metaforave. Për shembull,

përdorim metaforik: *Me dekë si me lé.* (me vdekë heroikisht)

përdorim metalepsik: *Ke me lé nesër.* (do të vdesësh e të bëshesh hero.)

përdorim metaforik: *Çka ban maca gjuan minj.* (e ama = e bija)

përdorim metalepsik: *Edhe kjo ka me gjuajt minj.* (ka me u bënë X; si e ama)

Metalepsa mund të zhvillohet edhe prej proverbash:

Shprehje (në MM): *Ngrihu heret se ke me gjetë portofolin.* (Këtu nënkuptohet që dikujt i humbë portofloi natën e kaluome. Ai që del jashtë i pari e gjen atë.)

Përdorim metalepsik: *Nesër ke me gjetë portofolin* (do të ngrihesh i pari)

Shprehje (në MM): *Ankesa është lypa, e lypa është deka.*

Përdorim metalepsik: *Vdiste me mbetë gjallë.* (Mbahej gjallë duke lypë.)

Shprehje (në MM): *Anmikut ruaju, por keq për të mos fol.*

Përdorim metalepsik: *Fliste mirë për anmikun e tij.*

Shprehje (në MM): *Asgja s' ta ban sa zëmriri.*

Përdorim metalepsik: *Shpikete mënyra me zëmrua ata që i urrente.*

---

<sup>3</sup> Më 28 Qershor, 1914, Gavrilo Princip vrau Arkdukën Franc Ferdinandi

## Antonomazia

ἄντονομάζω *āntonomázō* ‘emnim i rí + -iā.

Antonomazia është një tip metonomie. Ajo është një mjet ku, një epitet<sup>4</sup> ose frazë zëvendson një emën të përveçëm. Epiteti ose fraza zëvendsohet mund të funksionojë si emën i përgjithshëm. Ashtu si personifikimi, edhe kjo bazohet në marrdhanjen subjektivit me adjunktin<sup>5</sup> (Sister, 243).

Në qoftë se Gjergj Kastrioti është subjekti, atributet (en. adjuncts) e tij mund të përfshijnë legjislator (Ligji i Kurbinut), strateg (thyes i ushtrive perandorake), trim, çlirimtar, e të tjera. Në varsi prej rrethanave, secili prej këtyne emënave do të mund të përdorej në vend të emënit Gjergj Kastrioti, p.sh.,

### Antonomazia si epitet:

*Çlirimtari arriti në Krujë me 300 kalorës.*

Emëni ‘Stalin’ mund të zëvendsohet me epitetin ‘Diktator’, p.sh.,

*Diktatori e sundoi Europën lindore me internime, burgime, e vrasje.*

*Fybreri sulmoi Poloninë.*

### Antonomazia si frazë.

Sikur Fishta të njihej si *Homeri Shqiptar*, atbotë mund të thohej,

*Kryevepra e Homerit shqiptar është ‘Lahuta e Malcís’.*

## 3. Sinekdoxa

grc. συνειδοχή *sunekdokhé* ‘sinekdoxë’ Kjo trope është një tip metonomie a bazuome në **divizion** (Sister). Burke e pendson sinekdokën me *përfaqsinë*; pjesa përfaqson tansinë; tansia përfaqson pjesën, etj.

Përgjithsisht, sinekdokë quhet fenomeni ku zëvendsohen: *pjesa për tansinë, tansia për pjesën, specja për genusin, genusi për specjen, ena për përmbajtjen, materiali për objektin, etj.*

pjesa për tansinë :

*Para shtëpisë së tij kaloi flokverdha.* Këtu, flokët janë pjesë e tansisë (personit)

*Tehu i tij preu shumë anmiq.* Këtu, tehu është pjesë e shpatës.

tansia për pjesën:

<sup>4</sup> epitet - fjalë a frazë përshkruese, reale ose abuzive

<sup>5</sup> adjunct – 1. cilsi, karakteristikë, atribut, 2. ndihmës, 3. plotës rrethanor, 4. zëvendsoes

*Zagari ishte përlye me gjah.* Këtu, *gjabu* mund të ishte një lepur (tansia). Kurse landa me të cilën në fakt ishte përlye zagari ishte gjaku (pjesa).

*Kosova fitoi medaljen e artë.* Medalja e artë mund të ishte fituom prej *një atleteje* të vetëme ose prej *një skuadre*.

specia për genusin (lloji për gjininë; nënklasa për klasën):

*Dhambprehti po i sillej tufës.* Këtu, dhambprehti është specja, kurse bisha mishngranëse është genusi.

genusi për specjen:

*Shtaza u rá pulave.* Këtu, shtaza është genusi, specja është dhëlpëna.

ena për përmbajtjen:

*Diella pin kupën e fundit.* Këtu, kupa është ena që përmban pijen. Është pija që pihet, jo kupa.

landa/materiali për objektin:

*E bleu këmbshën me plastik.* Këtu, fjala *plastik* përdoret në vend të fjalës *kardë krediti*.

Këtu, tansia mund të përfaqsojë esencën a natyrën e diçkaje (kard krediti), ndërsa pjesa e përdorun si sinekdokë mund të përfaqsojë materialin (plastikun; landën me të cilin bëhet karda e kreditit).

## Disa sqarime

1. Tipikisht, sinekdoka njihet si një tip metonomie.

| Sinekdoka   | Metonimia  |
|---|--|
| Pjesa përfaqson tansinë, ose tansia pjesën, p.sh.,<br><i>Franca fitoi kupën.</i><br>(Ishte <i>skuadra</i> (pjesa) që fitoi, jo Franca (tansia). | Një koncept përfaqson një tjetër, p.sh., 'kunora' përfaqson 'monarkinë'.<br><i>Kunora britanike do të vizitojë vendin.</i><br>(Janë <i>titullarët e monarkisë</i> ata që do të kryejn vizitën, jo kunora.) |

2. Disa figura mund të shërbejnë edhe si sinekdokë edhe si metonomí, p.sh., *Ata kishin një mijë krenë dhen e dhí.*

Në këtë fjalí, termi 'krenë' është metonimí sepse ai përfaqson kafshët shtëpiake. Por, so është edhe 'sinekdokë' sepse kryet është pjesë e trupit (tansisë).

3. Krahaso a) dhe b) më poshtë

*Tebi i Gjergjit bani namin mbë ushtarët e bordave.*

*Shpata* është më e dobët se pena.

Këtu, 'tehi' është përdorun sinekdokisht sepse ai është pjesë e shpatës, kurse 'shpata' është përdorun metonimisht sepse ajo shoqnohet konceptualisht me fuqinë fizike.

#### Personifikimi

Personifikim quhet tropja ku një frymori joracional, një jofrymori, ose një ideje i jepen cilsí njerzore si: *ndjesia, gjykimi, ligjrimi*, e të tjera, p.sh.

*Besa ma ka lidhun gojën.*

Këtu, një koncepti a ideje (besës) i jepet aftsia me veprua si njeri.

1. Kjo trope mund të merret si një tip sinekdoke sepse këtu i dhantohet një sendi a frymori irracional një aspekt njerzor (arsyetimi). Kështu, tansia e qenjes lidhet me pjesën.
2. Ndërsa kafshët *personifikohen* (huazojnë aspekte prej natyrës njerzore), njerëzit mund të *bishifikohen*. Kështu, një personazhi që prej natyrës është njeri (qenje e arsyeshme), mund t'i jepet aspekti gjakatar i ujkut. Prandaj, b.f., kurdo që hana është e plotë, ky njeri kthehet në ujk.
3. Personifikimi gjindet në çdo tip shkrimi letrar, por është më e zakonitë në fabula, p.sh: *ariu mund të japi këshilla, ujku mund të planifikojë strategji për të, dhëlpëna mund të arsyetojë cila dredhi do të ishte më e suksesëshme*, e të tjera. Në këta shembuj, kafshëve u janë dhanë aftsi njerzore si *urtsia, planifikimi, dhe gjykimi*.
4. Në traditën gojore dhe të shkruome shqipe disa kafshë përfaqsojnë cilsí thalbsore qenjesh njerzore, p.sh.:

ariu – *atnia*

cjapi – *seksualiteti*

bleta – *puntoria*

breshka – *ngadalsia dhe urtsia*

dashi – *vendosmënia*

delja – *butsia*

dhëlpëna – *dredhia (greq. dinakria)*

dhia – *Në mitologjinë shqiptare dhia preket nuk prej magjisë*

gjarpëni – *pabesia dhe përpikmënia*

gjeli – *mendjemadhsia e kotë*

gomari – *trashsia mendore*

kali – *madhështia*

korbi – *vdekja*

krimbi – *ndytsina, kjangsia*

lepuri – *droja (lat. frika) dhe shpejtsia*

mushka – *durimi (... mushka drutë) dhe kamngulja (trumushkë)*

pëllumbi – *paqa*  
shqyponja – *largpamsia dhe dlirsia shqisore*  
ujku – *mizoria*

Disa shembuj personifikimi, ose ku cilsitë e një gjâje i jepen një tjetre, pasojnë:

*Ambëlçina të shkrihej në gojë.*

*Ankthi kishte formuom një nye në gjoksin e tij.*

*Dera e hekurt gjëmoi me zã të ndryshët.*

*Dielli po i torturonte njerezit me zhegun përvëlues të korrikut.*

*E kaluomja e ndiqte si vaji i travës.*

*Fluturat vallzonin me gëzim në kopështin e luleve.*

*Gjethet i pëshpërisnin njëna-tjetrës.*

*Hana u ndriçoi udhën treqind kalorësve që donin t'i sillnin popullit të tyne lirinë.*

*Harusha e Madhe i printe Çojës drejt Alpeve.*

*Heshtja flet më shum se fjalët.*

*Mjegulla po zvarritej drejt shtëpiave.*

*Shiu po trokiste në dritare.*

*Stubia ulërinte e zëmruome.*

*Trishtimi qëndronte i pezulluom mbi qytetin e pushtuom.*

*Uzdaja vezullonte në sytë e saj të mahnitun.*

*Valët e detit sillnin lajme në breg pastaj tërhiqeshin.*

*Vetëtima çau qiellin.*

*Zëmrime vlonte në gjinin e saj.*

#### 4. Ironia

Burke shkruan, *ku veprojnë idetë ka dramë; ku veprojnë personazhet ka ironi*. Ironia është një trope e bazuome në nocionin e kundërshtive (Sister, 245). Kjo trope gradon prej në *ekstremin sarkastik* te *shprehjet të lehta ironike*. Në mes këtyne ekstremeve ka një mijë nuanca ironike, për të cilat, fatkeqsisht, ne nuk kemi emëna (Brooks, 397).

Disa e vërejnë ironinë prej perspektivës së viktimizuesit (ironistit) dhe viktimës, atij që gjindet në një situatë të pafavorëshme.

*Të dua shum, prandaj së shpejti do t'a dërgoj shpirtin në qiell.*

(Shakespeare, Richard III)

Këtu, personazhi që flet këto fjalë shfrytëzon dialektikën, siç e quan Bruke, ose kundërshtinë, mospërkimin, a mospajtimin e dy situatave; *dashnisë* dhe *vrasjes*.

Njihen tri tipe kryesore ironie: verbale, situative, dhe dramatike. Disa shtojnë edhe Sokratike, romantike, ose tragjike.

#### Ironia verbale

Në këtë figurë përspiqen gramatika me semantikën; kuptimi që nxirret tekstualisht (literalisht) prej gramatikës (përmbajtjes) merret afërsisht në kuptim të kundërt. Megjithatë, kundërshtia skajore mund të anojë më shumë kah vulgariteti i sarkazmës sesa kah thellsia e mprehtsia e ironisë.

Tipikisht, autori i ironisë verbale përdorë koncepte smadhuese si amplifikimi, p.sh., hipërbolën a mbiasertën (en. overstatement), ku diçka smadhohet në randsí a vlerë; ose litotën a nënasertën (en. understatement) ku diçka zvoglohet në randsí a vlerë.

- Mbiaserta: Kur Xhulieta refuzon të martohet me Parisin:

*Asht një nderim që nuk andërroj ta kemë.*

- Nënaserta: Kur Markutio plagoset për vdekje:

*Një gërvishje, një gërvishje.*

*Ironia Sokratike* është një tip ironie verbale, ku personi luan rolin e injorantit në mënyrë që ta nxisi ndërkumtuesin e tij me shprehë një bindje rreth një subjekti, p.sh,

X: *Si mund t'a përkufizoni aretenë?*

Sokrati: *Fjalë interesante. Nuk e kuptoj, por jam me fat që ju jeni këtu dhe mund të na e shpjegoni.*

#### Situata ironike

Këtu ndodhë e kundërta e asaj që pritet.

*Edipi, duke mësua që ai ishte i destinuom me vrá të jatín dhe me u martua me të amën, ikë prej shtëpisë që ai e njihje për atnore. Por, në fund të fundit, ai nuk mund t'i shmanget fatit të tij.*

#### Ironia dramatike

Audienca din diçka që një ose disa personazhe nuk e dinë. Këtu drama ka tri faza:

1. *S'pari* audiencës i jepet një informacion që një ose disa personazhe nuk e kanë. Tipikisht, ky informacion ka lidhje me njëfarë rreziku që e pret personazhin e painformuom.
2. *Pastaj*, personazhi, pa e ditë, i afrohet rrezikut. Në këtë situatë, audienca dëshiron t'i thotë atij 'mos u afro'. Shkujdesja e personazhit dhe frika që audienca ndjen për të

janë kontrastuese. Ky kontrastim krijon pezullim. Asht sikur me pa dikë që po i afrohet një kurthe, por nuk mund t'i tregosh sepse ai ndodhet në një dimension tjetër.

3. *Përfundimisht*, personazhi e kupton situatën; por mund të jetë tepër vonë.

Ky tip ironie mund të quhet edhe ironi *tragjike*, p.sh.,

Në një pikë të dramës *Edipi Mbret*, bâhet e qartë që Edipi është vrasësi i të jatit. Ai nuk e din këtë, por disa personazhe të tjera e dinë. Edhe audienca mund ta ketë kuptua këtë të vërtetë. Kështu, sa herë që Edipi ngulmon me gjetë vrasësin, personazhet tjerë dhe audienca dëshirojnë ta paralajmrojnë. Dhe disa bajnë pikrisht këtë, por ai nuk dëgjon. Kjo situatë krijon pezullim.

Në dramën *Makbeti*, audienca e din që personazhi Makbeti do të vrasë mbretin, por mbreti nuk e din këtë. Kështu, audienca dëshiron ti tregojë këtij mbreti të mos flejë në shtëpinë e Makbetit, por ajo nuk mundet sepse personazhet ndodhen në një dimension, a botë, tjetër.